

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: Edukim figurativ

(klasa e katërt)

VITI SHKOLLOR 2007--2008

Tiranë, 2006

1. TË PËRGJITHSHME

Programit i edukimit figurativ për klasën e katërt ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën e zbulon, e zhvillon dhe e pasuron duke e ndërthurur në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën, artin jo vetëm të qendrës ku jeton e mëson fëmija, por edhe me atë të krahinave të tjera të e të vendeve të ndryshme të botës. Ky program i jep mundësi nxënësit të përftojë njohuri dhe t'i interpretojë ato në mënyrë origjinale. Gjithashtu programi synon t'i aftësojë nxënësit për të krijuar nëpërmjet artit figurativ.

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të nxjerrin në pah lidhjet e artit figurativ me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore, me mjedisin ku zhvillohet. Lidhjet e artit me jetën do të pasqyrohen në punimet e nxënësit, i cili mund të krijojë pasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ etj.

Formimi artistik i nxënësit do të realizohet duke i pajisur ata me:

Njohuri:

a) *për bazën materiale* që është përdorur edhe në klasat e mëparshme dhe në ato që do të përdorin këtë vit, për teknikën për të realizuar një vepër arti, si: kolazhe, akualet, temperë etj., stampime me stampa të përgatitura nga vetë nxënësit;

b) *për elementet e parimet e artit* duke zgjeruar njohuritë dhe duke përdorur ngjyrat e para e të dyta, zgjerimin e njohurive për llojet e vijave, perspektiva lineare për objektet afër-larg, simetria boshtore, format me 2-3 përmasa, baraspeshën, theksin, lëvizjen, unitetin, kontrastin;

c) për përdorimin e simboleve e të tematikave të larmishme nga jeta e tyre e mjedisi;

d) *për historinë e kulturën e artit figurativ* të vendit dhe të huaj;

e) *për analizën, vlerësimin, interpretimin* e një punimi të vet artistik, të një punimi të shokut apo të një vepre të caktuar arti, si dhe zhvillimin e një fjalori të caktuar artistik;

f) *për rolin e artit dhe të artistit* në komunitet e në jetën e përditshme.

Aftësi:

a) *për të vëzhguar e për të dalluar* ngjyrat e para e të dyta, për përdorimin e akualetit, pastelit, temperës, marrëdhëniet në mes rrethit të ngjyrave, përcaktimin e ngjyrave të ftohta e të ngrohta; përcaktimin e sipërfaqeve për të krijuar me teknikën e kolazhit.

b) *për përshkrimin dhe interpretimin* e karakteristikave të një vepre arti dhe karakterin historik të tyre me fjalë shumë të thjeshta;

c) për të sjellë përvojën e tyre në klasë; si dhe aftësi praktike për të krijuar një ilustrim;

d) *për të analizuar dhe për të vlerësuar* në bazë të njohurive të marra punën e tyre e të shokut apo një vepre arti;

e) *për bashkëpunimin dhe punën në grup*, për të dëgjuar mendimin e shokut, për të krijuar miqësi e për të pakësuar mosmarrëveshjet;

f) *për ta gjetur të bukurën* në orenditë shtëpiake, rregullimin e mobilieve në arkitekturën e ndërtesave, në arkitekturën e mjedisit;

g) *për të përdorur imagjinatën, fantazinë, ëndrrat* në veprimtarinë krijuese.

h) *për përdorimin e bazës materiale*, si: lapsi, goma, peneli, bojërat, pastelet, plastelina etj.;

i) *për përdorimin e një fjalori të thjeshtë artistik* në përcaktimin e elementeve të artit dhe të karakteristikave të tyre.

Qëndrime:

a) *për të qenë të pavarur në vlerësime* e në dhënien e mendimeve;

b) *për të respektuar* mendimin e tjetrit për atë që kanë e duan të transmetojnë me punën e tyre;

c) *për të marrë përgjegjësi* për punën që bëjnë, për përgjigjet që japin, për lidhjet që krijojnë.

Vlera:

a) *respektimi i lirive* e të drejtave të njeriut në këtë fushë, si: përzgjedhja e materialeve, elementeve, parimeve për të shprehur idetë, mendimet e ndjenjat e tyre;

b) *respektimi i traditave* e zakoneve; *realizimi i detyrave* e përgjegjësive për të përfunduar një detyrë.

Programi është hartuar mbi gjashtë linja kryesore, të cilat janë karakteristike për të gjitha fushat e artit pamor. Kjo e bën më të plotë njohjen dhe formimin e nxënësit, në krahasim me programin e mëparshëm, i cili zhvillohej në fushat kryesore të artit figurativ.

Lënda do të zhvillohet në 35 javë mësimore me nga 1 orë në javë.

2. SYNIMET

Programi i edukimit figurativ në klasën IV ka për synim të ndihmojë në formimin artistik të nxënësit për të kuptuar artin figurativ dhe për t'u shprehur nëpërmjet tij.

Në fund të klasës së katërt nxënësi / sja duhet të jetë i/e aftë:

- Të krijojë punë të ndryshme arti, në 2 –3 përmasa, që komunikojnë ide, mendime, ndjenja, përvoja, me një qëllim të caktuar për këtë nivel;
- Të përdorë elementet dhe parimet e artit (ngjyrat, vijat, formën, hapësirën, sipërfaqet) në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel;
- Të përshkruajë si elemente të ndryshme të artit (të ndeshura në vepra arti) lidhen me njohuritë dhe përvojat e veta;
- Të përdorë një fjalor dhe terminologji artistike, të thjeshtë për këtë nivel.

3. LINJAT E PËRMBAJTJES

- Baza materiale, procese, teknika

- Parime dhe elemente

- Tematika

- Histori dhe kulturë

- Analiza, interpretimi dhe vlerësimi

- Lidhjet me jetën dhe mjedisin

4. OBJEKTIVAT, NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE

Linja I. Baza materiale, procese, teknika

Nxënësi/sja duhet të njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

-Të përdorë *materiale* të ndryshme duke njohur efektet që ato krijojnë: lapsa, pastela, shkumësa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartonë, letër e zakonshme, bojëra uji, tempera, furça, plastelinë, materiale për gdhendje.

(P.sh: diskutim dhe demonstrim të mjeteve dhe materialeve në klasë).

- Të njohë dhe të përdorë *teknikat, si:* akuareli, tempera, stampimi, vizatimi, modelimi i baltës (plastelina), gdhendja (në sapun), kolazhi, tekstili etj.

(P.sh: diskutim dhe demonstrim të teknikave në klasë).

Njohuritë (mjete) dhe aftësi kryesore: akuareli, stampimi, vizatimi me laps dhe shkumësa, modele me plastelinë, gdhendja me sapun, kolazhi. Aftësia për të punuar me plastelinë dhe ndarjen në porcione, përdorimi i penelit, dhënia e linjave, krijimi i stampave me gdhendje, ndërthurja e materialeve në teknikën e kolazhit.

Linja II. Elemente dhe parime

Nxënësi/sja duhet të njohë e të përdorë elementet e parimet e artit në punimin e tij.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të përdorë vija të ndryshme në një punim me 2-3 përmasa, për të dhënë idenë e sipërfaqes (*Vijat*). *(P.sh: Peizazh – modelon gjatë krijimit sipërfaqen nëpërmjet vijave).*

-Të përdorë format për të krijuar hapësirat pozitive dhe negative (*Format me 2 dhe 3 përmasa, p.sh: Krijim -: “Dita e karnavaleve”, poster*).

- Të përdorë sipërfaqe të ndryshme për të krijuar variacione në punën e tyre (*Sipërfaqja p.sh: Krijim - një objekt 3- përmasor, ku të përdoren 3 sipërfaqe të ndryshme*).

- Të përdorin ngjyrat e errëta dhe të çelëta në punimet e veta, duke përdorur të paktën 3 nuanca (*Ngjyra p.sh: Krijim me akuarel*).

-Të krijohet ideja e thellësisë, duke përdorur mbivendosjen e trupave dhe perspektivën me një pikë (*Hapësira p.sh: peizazh - pamja e qytetit (ky punim mund të përdoret për të realizuar dhe konceptet të tjera*).

-Të përdorë ngjyrat, vijat, format për të krijuar një punim me balancën asimetrike (*Baraspesha p.sh:Krijim i lirë*).

- Të krijojë theksin në punën e tij, duke përdorur ngjyrat, vijat, format, masat (*Theksi p.sh: Klouni*).

-Të përdorë përsëritjen e një forme të vetme në krijimin e tij, duke dhënë kështu idenë e lëvizjes (*Lëvizja*)

-Të krijojë unitetin në një punim (*Uniteti p.sh: Krijimi, p.sh., shkruaj në mënyrë argëtuese "Gëzuar ditëlindjen!"*).

-Të përdorë ngjyrat e errëta dhe të çelëta për krijuar kontrastin (*Kontrasti p.sh: Krijim: "Në plazh"*).

-Të përcaktojë ritmin në natyrë apo në një vepër arti, nga përsëritja e një modeli. (*Harmonia, p.sh: Krijim i një motivi të thjeshtë, për shembull, qilima me motive popullore*).

Njohuri dhe aftësi kryesore: - për elementet: *efektet e vijave* (diagonale, horizontale, zigzag në një punim artistik); *planet* dhe përdorimi i tyre për të krijuar hapësirën; përcaktimi i *sipërfaqeve* të ndryshme; *efektet e ngjyrave* në një punim. Për parimet: baraspesha asimetrike, theksi, kontrasti, uniteti, harmonia. Përshkrimi dhe përdorimi i elementeve dhe parimeve në punimet artistike.

Linja III. Tematika

Nxënësi/sja duhet të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash. simbolesh, idesh nga jeta e tij.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

-Të diskutojë si artisti gjen motivimin e veprës së tij, duke u frymëzuar nga veprimtari të jetës, si: gëzimet, hidhërimet, luftërat, dasmat, këngët etj. (P.sh: Diskutim rreth pikturës, për shembull: Kol Idromeno "Dasma shkodrane").

-Të krijojë sipas imagjinatës, shijeve dhe interesave të tij, (p.sh: Krijim - Një revistë ku në të mund të ngjiten foto, mesazhe të ndryshme të marra nga revistat, gazetat etj).

-Të përdorë simbolet për të paraqitur harta, planimetri, (për shembull: vizatimi i simboleve të thjeshta, të qarkullimit rrugor ose vizatimi i një plani të thjeshtë të shkollës apo të lagjes ku jeton).

Njohuri dhe aftësi kryesore: *tematika* e punimeve nga natyra e jeta e njeriut, dekorative, nga kujtesa, fantazia, *simbolet*. Gjithashtu nxënësi/sja është i/e aftë të dallojë, të përshkruajë dhe të përdorë simbolet, imagjinatën, fantazinë, idetë në shërbim të krijimit artistik.

Linja IV. Historia dhe kultura

-Të përcaktojë në kuptim të përgjithshëm ndryshimet dhe ngjashmëritë e artit lokal me atë kombëtar.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të përcaktojë rolin që luajnë përdorimi i vijave, modeleve etj., në artin lokal dhe kombëtar (p.sh: Diskutim - karakteristikat e kostumeve popullore kombëtare ose krahasimi i vazove të qeramikës nga krahina të ndryshme të vendit).

-Të përcaktojë e të diskutojë për ndikimin që luan mjedisi gjeografik në artin lokal apo kombëtar (p.sh: Vizitë në galerinë e arteve).

- Të përshkruajnë veshjen në periudha të ndryshme kohe (p.sh: Diskutim - veshja e një luftëtari, kostumet për ceremonitë e festave etj).

Njohuri dhe aftësi kryesore: *Motivi bazë* i veshjeve, i punimeve në metale e qeramikë, i tekstileve, i shtëpive të krahinës, qytetit, vendit dhe *karakteristika të ndërtesave e të veshjeve* të fshatit, qytetit apo të krahinës, pare edhe nga koha që i përkasin. Përshkrimi i karakteristikave të artit të krahinës apo të vendit. Përdorimi i artit popullor në ditët ceremoniale.

Linja V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

Nxënësi/sja duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, dhe të vlerësojë punimet e tij/saj dhe të shokut/qes.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësi/sja të jenë në gjendje:

-Të krahasojë dhe të analizojë dy vepra arti që trajtojnë të njëjtën temë, të realizuara në periudha të ndryshme (p.sh: Diskutim - portreti i Mona Lizës nga Leonardo da Vinci dhe “Motra Tone” nga Idromeno).

- Të përcaktojë ndryshimet dhe ngjashmëritë në punime të ndryshme të artit (p.sh: Diskutime - për piktura, skulptura, punë artizanale etj.

Njohuri dhe aftësi kryesore: përshkrimi, analiza, vlerësimi, gjykimi, diçitura (leximi i të dhënave në një vepër arti). Zhvillon aftësitë dalluese, përdorimin e fjalorit, aftësitë përshkruese, krahasuese në shërbim të temave që punohen.

Linja VI. Lidhja me jetën dhe mjedisin

Nxënësi/sja duhet të bëjë lidhjet mes artit figurativ dhe disiplineve të tjera në jetën e përditshme.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësi/sja të jenë në gjendje:

-Të diskutojë për përdorimin e kontrastit në zbukurimin e mjediseve, (p. sh., nëpër reklama).

-Të përcaktojë dhe të përshkruajë rolin e përdorimit të vijave, ngjyrave, përmasave për të tërhequr vëmendjen në një zbukurim, në një veshje, paketim etj. (*Krijim - album fotografik me njerëzit e familjes (krahasimi i fotove në periudha të ndryshme)*).

-Të përcaktojë ndikimin gjeografik në arkitekturën e një vendi (p.sh: *Diskutim pas një vizite në një galeri ose muze*).

Njohuri dhe aftësi kryesore: *arti i reklamave* në dyqane, në filma në sport, *efektet e elementeve të artit* në një paketim për ditëlindje në një ftesë, në një album fotografik. *Arkitektura* në ndërtesa me relievin gjeografik të një vendi, p.sh., *funksioni i çatisë* së ndërtesës në një vend malor dhe në një vend të nxehtë.

Përshkrimi dhe përdorimi i reklamave, të albumit fotografik, etiketave, paketimeve, lidhjet e relievit me artin e zonës.

5. SHPËRNDARJA E ORËVE

Në klasën e katërt të arsimit të detyruar 9-vjeçar, edukimi figurativ zhvillohet në 35 javë mësimore me 1 orë në javë. Përdoruesit e këtij programi duhet të kenë parasysh që të planifikojnë orë përsëritjeje të vazhdueshme mbi njohurive të marra.

$$35 \text{ javë} \quad \times \quad 1 \text{ orë} = 35 \text{ orë vjetore}$$

Linjat	Sasia e orëve
Baza materiale, procese e teknika	2 orë
Elemente dhe parime	16 orë
Tematika	3 orë
Histori dhe kulturë	3 orë
Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
Lidhja ndërlëndore me jetën dhe mjedisin	3 orë
Orë të lira	5 orë

Orë të lira

Qëllimi i orëve të lira (deri në 15% e sasisë totale të orëve) janë lënë të lira në dispozicion të mësuesit. Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtoritë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i orëve të lira është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit. Grumbullimi i fakteve, të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve apo vizitave në qendra të ndryshme kulturore si në galeri arti, muze, kala, ndërtesa karakteristike apo shtëpi muze etj., janë veprimtari praktike të pasuara me detyra të cilat janë në shërbim të një objektivi të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës për një linjë; organizimi i ekspozitave, biseda dhe diskutime me artistë të ndryshëm. Përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesit, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërnlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërnlëndore dhe u shërbën arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. INTEGRIMI

Programi i edukimit figurativ jep mundësinë që në tema të shumta të zhvillohet integrimi i njohurive dhe aftësive me ato të lëndëve të tjera. Përmes këtij integrimi nxënësit mësojnë të studiojnë konceptet jo vetëm në një lëndë por në disa, brenda fushës dhe jashtë saj. Kështu në matematikë njihen me format në kuptimin matematik. Gjithashtu në këtë lëndë përmes studimit të formës, ngjyrës etj., nxënësi mëson të lidhë krijimin e tij me *simbolet kombëtare* që ai i mëson edhe në histori. **Pra** nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet edukimit figurativ dhe matematikës, historisë, diturisë së natyrës, edukatës qytetare dhe gjeografisë duke gjetur të përbashkëtat dhe duke kuptuar që ato mund të përdoren në fusha të ndryshme ku ata përgatiten.

Integrimi në linjën e “Elementeve dhe parimeve” mund të bëhet me: me matematikën format dhe trupat gjeometrikë. Format mund të lidhen edhe me njohuritë të marra në diturinë e natyrës.

Integrimi në linjën e “Tematikës” bëhet me diturinë e natyrës dhe edukatën shoqërore e parë kjo nga tema në të cilën do të përcaktojë mësuesi/sja për realizimin e objektivave dhe njohurive.

Integrimi në linjën e “Historia dhe kultura”, bëhet me lëndën e historisë dhe edukatës shoqërore.

Gjithashtu integrimi do të bëhet edhe përmes ndërthurjes së koncepteve bazë të lëndëve me njëra tjetrën, të metodologjive si dhe me shkencat më të përafërta.

Aspektet kros-kurrikulare janë patur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;

- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Zbatimi me sukses i programit kërkon përgatitje dhe përgjegjësi nga përdoruesit të cilët duhet të drejtojnë e të nxisë veprimtarinë e nxënësit. Përdoruesit duhet të njohin shumë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale apo të drejtuar nga institucionet përgjegjëse, të krijojnë një bazë të domosdoshme materiale për t'i paraprirë një zhvillimi normal të orës së mësimit, të sqarojnë më parë të gjitha çështjet e paqarta të përmbajtjes që mos të jetë në dilemë për atë që do t'i transmetojë nxënësit. Tek zberthimi i secilës linjë janë dhënë niveli i përvetësimit të koncepteve, teknikat, aftësitë, shprehitë si dhe tema të mundshme për hartimin e planit konkret. Plani mësimor ndërtohet në 6 rubrika, si: 1) Tematika; 2) Tema për çdo orë mësimi; 3) Nënlinjat; 4) Mjetet; 5) Teknikat dhe 6) Shënime për detyrat a problemet që dalin. Për zbatimin me sukses të programit në përgatitjen ditore të parashikohet dhe veprimtaria në grup e të gjithë nxënësve dhe për nxënësit me probleme, sidomos detyra të veçanta të parashikohen për nxënësit e talentuar. Njëkohësisht është e domosdoshme që për të pasur rendiment në zbatimin e programit, të vendosen lidhje me artiste të zonës ku jetojnë nxënësit, të realizohen veprimtari, si: ekspozita me një tematikë të caktuar, biseda, vizita në studiot e piktorëve etj. Nga realizimi me sukses apo jo i orës së mësimit bëhet nxitja ose frenimin i interesave të nxënësit për artin.

Mjetet dhe përdorimi i tyre

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të një veprimi të tillë, mund këshillohet për të përdorur mjetet në grup.

Grupi i parë:

-shkumësa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë:

-vinovil, letër-ngjyëse, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë:

-penela të ndryshme, të cilat janë të përcaktuar në paketa të veçanta (penelat të jenë të disa madhësive), fletore vizatimi, fletore punëdore, letër tabak, kartonë me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt:

-mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempere, akuarele.

Grupi i pestë:

-mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurativ, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, me një vend të sigurt ku t'i mbështes mjetet e tij, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa studio. Në pamundësi të sigurimit të studios, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

8. VLERËSIMI

Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në standardet e arritjes, një dokument të cilin çdo përdorues duhet ta ketë gjithmonë pranë, për të qenë sa më i qartë e i saktë në veprimtarinë e përditshme mësimore. Metodologjia për të vlerësuar nxënësit nuk do të bazohet në konkurrencë, por në bazë të një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe ato që nxënësi duhet të realizojë më mirë. Në diskutim të marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të orës së mësimin. Ky diskutim zakonisht bëhet në fund të orës së mësimin. Në vlerësim do të merret parasysh dhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Vlerësimi me notë bëhet me grup -tema për të gjithë nxënësit apo dhe në mënyrë individuale sipas kriterëve që mund të vendosë shkolla.